

# Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Raporti për Shqipërinë  
2021



monitoring  
matrix

# ***Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile***

Raporti Përmbledhës për Shqipërinë 2021

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Qershor 2022



Co-funded by  
the European Union



**CSO Partnership**  
for **Development Effectiveness**

**Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile**

Adresa: Macedonia Street 43-1/9, 1000 Skopje, Republic of North Macedonia

Telefon: +389 2 6144 211

Email: [executiveoffice@balkanccd.net](mailto:executiveoffice@balkanccd.net)

Faqe Zyrtare : [www.balkanccd.net](http://www.balkanccd.net)  
[www.monitoringmatrix.net](http://www.monitoringmatrix.net)

**Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim**

Adresa: Elbasan Street, PARK GATE, 10th Floor, Ap. 71/73, Tirana

Telefon: 00355 4 2254 881

Email: [partners@partnersalbania.org](mailto:partners@partnersalbania.org)  
[info@resourcecentre.al](mailto:info@resourcecentre.al)

Faqe Zyrtare : [www.partnersalbania.org](http://www.partnersalbania.org)  
[www.resourcecentre.al](http://www.resourcecentre.al)

**Autorët:**

Kostandina Këruti

Klotilda Kosta

Juliana Hoxha

Ky publikim u mundësua përmes mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian, Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida) dhe IBON International përmes CSO Partnership for Development Effectiveness (CPDE). Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikpamjet e Bashkimit Evropian, Sidas dhe IBON International.

# Tabela e Përmbajtjes

Përmbledhja ekzekutive	6
Vështrim i përgjithshëm i shoqërisë civile	6
Gjetjet kryesore	7
Rekomandimet kryesore	8
Gjetjet	9
Fusha 1: Garancitë themelore juridike të lirive	9
Nën-fusha 1.1. Liria e organizimit	9
Nën-fusha 1.2. Liritë e tjera	11
Fusha 2: Kuadri për qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat financiare për OJF-të	13
Nën-fusha 2.1. Trajtimi tatimor/fiskal për OJF-të dhe donatorët e tyre	13
Nën-fusha 2.2. Mbështetja e shtetit	14
Nën-fusha 2.3. Burimet njerëzore	16
Fusha 3: Marrëdhëniet Shtet-OJF	18
Nën-fusha 3.1. Korniza dhe praktikat për bashkëpunim	18
Nën-fusha 3.2. Përfshirja në procesin e vendimmarrjes dhe politikave	19
Nën-fusha 3.3. Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve	22

# Shkurtime

<b>AAPSK</b>	Agjensia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara
<b>AMSHC</b>	Agjensia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
<b>DPT</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
<b>FT</b>	Financimi i Terrorizmit
<b>KM</b>	Këshilli i Ministrave
<b>MSHMS</b>	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
<b>MM</b>	Matrica e Monitorimit
<b>OJF</b>	Organizata Jofitimprurëse
<b>PQH</b>	Partneriteti për Qeverisjen e Hapur
<b>PPP</b>	Parandalimi i pastrimit të parave
<b>TIK</b>	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

# Përmbledhja ekzekutive

## Vështrim i përgjithshëm i shoqërisë civile

	2021
Numri i organizatave të regjistruara (për lloj) (+ sa janë regjistruar në 2021)	12,240 OJF  278 OJF të regjistruara në 2021 156 Shoqata 73 Qendra 49 Fondacione
Ligjet kryesore të shoqërisë civile	Kodi Civil i Shqipërisë Ligji nr. 8788 "Për Organizatën Jofitimprurëse" Ligji nr. 8989 "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse" Ligji 80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse" Ligji 65/2016 "Për Sipërmarrjen Sociale"
Ndryshimet përkatëse në kuadrin ligjor	Ligji 80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse" Ligji 107/2021 "Për Bashkëqeverisjen" Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
Financimi shtetëror (për vitin e kaluar) (organet kryesore dhe shumatat)	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile 90 milionë lekë (rreth 744,000 EUR)
Burimet njerëzore (punonjës dhe vullnetarë)	9,872 punëdhënës Nuk ka të dhëna mbi vullnetarizmin
Bashkëpunimi OJF-Qeveri (organi përkatës dhe i ri: mekanizmi konsultativ)	Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile
Sfida kryesore (p.sh. mungesa e të dhënave zyrtare në lidhje me shoqërinë civile)	- Mungesa e të dhënave të unifikuara dhe informacionit të saktë për OJF-të - Efektiviteti i bashkëpunimit OJF-Qeveri mbetet i ulët

## Gjetjet kryesore

### Gjetjet kryesore të raportit

1.	Ligji 80/2021 për regjistrimin e OJF-ve u miratua me reagime dhe kritika të forta nga OJF-të.
2.	Kodi Penal u ndryshua duke njohur të drejtën e tubimit pa leje (vetëm njoftim) nga policia e shtetit, në përputhje me standardet ndërkombëtare.
3.	Pas vitesh diskutimesh, advokimit të sektorit dhe bashkëpunimit me institucionet publike përgjegjëse, procedura e rimbursimit të TVSH-së për grantet, e dhëna në përputhje me marrëveshjet financiare të ratifikuara nga Kuvendi apo marrëveshjet e granteve të miratuara nga KM, ka nisur zbatimin me 4 projekte të rimbursuara.
4.	Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të OJF-ve ndaj FT-it është në proces përgatitjeje, e cila do të kontribuojë në një qasje të bazuar në risk për sektorin e OJF-ve mbi masat PPP/ LFT
5.	Konsultimet dhe pjesëmarrja e OJF-ve në proceset politikbërëse dhe vendimmarrëse mbeten joefektive, pavarësisht nga mekanizmat e bashkëpunimit të vendosur nga qeveria.
6.	Një sistem i ri faturimi dhe monitorimi i aktiviteteve të të gjithë tatimpaguesve të regjistruar, përfshirë OJF-të, zbatohet nga autoritetet tatimore shqiptare, duke çuar në fiskalizimin e sektorit.

## Rekomandimet kryesore

### Rekomandimet kryesore të raportit

1. Me miratimin e ligjit të ri për regjistrimin e OJF-ve, është shumë e rëndësishme që një ligj i ri për OJF-të të zëvendësojë Ligjin 8788/2001, të ndryshuar, për të reflektuar ndryshimet në sektorin e OJF-ve dhe kuadrit ligjor ndër vite.
2. Nevojitet amendimi i ligjit për regjistrimin e OJF-ve, për të adresuar çështjet kryesore të mbetura, të identifikuara nga OJF-të gjatë procesit të konsultimit.
3. Fillimi i zbatimit të procedurës së rimbursimit të TVSH-së për shpenzimet e aktivitetit të granteve, kërkon rritjen e ndërgjegjësimit të institucioneve të huaja donatore për të sjellë certifikimin e raporteve të tyre të financimit në përputhje me procedurën. Kjo do t'i mundësojë OJF-ve të kenë më shumë fleksibilitet për të kërkuar rimbursimin e TVSH-së në baza të shpeshta kundrejt kontratës së përgjithshme të financimit, siç po ndodh tani.
4. Masat shtetërore për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit (PPP/LFT), të cilat targetojnë OJF-të, duhet të sigurojnë gjithashtu mbrojtjen e tyre nga abuzimi dhe të mos pengojnë punën legjitime të OJF-ve.
5. Financimi publik për sektorin e OJF-ve duhet të jetë transparent, i shoqëruar me llogaridhënie publike dhe instrumente raportues për ndikimin e tij.
6. OJF-të duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin e integritetit në BE, duke përdorur efektisht hapësirën që kanë në Platformën e Partneritetit për Integrim Evropian dhe mekanizma të tjerë konsultativë, ndërkohë që institucionet publike duhet t'i bëjnë këto mekanizma efektivë përmes protokolleve transparente të pjesëmarrjes dhe njohjes së kontributit të OJF-ve si partner legjitim në proces.



# Gjetjet

## Fusha 1: Garancitë themelore juridike të lirive

### Nën-fusha 1.1. Liria e organizimit

#### 1.1.1. Themelimi dhe Pjesëmarrja në OJF

Në total janë **12,240 OJF** të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, i vetmi autoritet publik përgjegjës për regjistrimin e OJF-ve në vend<sup>1</sup>. Në vitin 2021 janë regjistruar **278 OJF të reja**, nga të cilat 156 janë shoqata, 73 qendra dhe 49 fondacione. Rreth 44 kërkesa për regjistrim janë refuzuar nga Gjykata dhe 48 kërkesa u janë kthyer subjekteve kërkuese për rishikim.

Në total, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT) janë të regjistruara **5,174 OJF**, nga të cilat **2,217 OJF** (rreth 42%) kanë status aktiv<sup>2</sup> dhe 946 janë të regjistruara në skemën e TVSH-së<sup>3</sup>. Bazuar në përgjigjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, koha mesatare e regjistrimit të një organizate nga dita e paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit është **67.3 ditë**, katër herë më shumë se periudha (15 ditë) e parashikuar në ligjin “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”.

Në gusht 2021 u miratua Ligji 80/2021 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”<sup>4</sup>, duke përbushur masën 6.1 të Udhërrëfyesit 2019–2023<sup>5</sup>. Kjo nismë e qeverisë erdhi si një përpjekje për të adresuar një nga rekomandimet e raportit të MONEYVAL “Masat Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Raporti i Raundit të 5-të të Vlerësimit të Ndërsjellë për Shqipërinë”<sup>6</sup>, i cili kërkonte krijimin e një

<sup>1</sup> Informacioni u sigurua nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pas kërkesës për informacion dërguar nga Partnerët Shqipëri

<sup>2</sup> Status aktivë nënkupton që organizata ka kryer aktivitete për një periudhë tatimore prej 12 muajsh të njëpasnjëshme

<sup>3</sup> Informacioni u sigurua nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, pas kërkesës për informacion dërguar nga Partnerët Shqipëri

<sup>4</sup> Fletore Zyrtare 121/2021 [Online] <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2021/06/24/80/852c9af6-f25b-492e-aa48-577ff8077583>

<sup>5</sup> Marrë nga faqja e Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile [Online] <https://resourcecentre.al/wp-content/uploads/2021/08/ligj-nr.-802021-dt.-24.6.2021.pdf>

<sup>6</sup> MONEYVAL, 2018, “Masat Kundër Pastrimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Raporti i Raundit të 5-të të Vlerësimit të Ndërsjellë për Shqipërinë” [Online] <https://rm.coe.int/committee-of-experts-on-the-evaluation-of-anti-money-laundering-measur/16808ff13>

regjistri elektronik për OJF-të. Procesi për këtë nismë ligjore u shoqërua me një debat të ashpër mes sektorit jofitimprurës nga njëra anë dhe Ministrisë së Drejtësisë dhe Parlamentit nga ana tjetër. Kritikën nga sektori jofitimprurës kanë qenë të dyfishta. Së pari, lidhur me procesin e konsultimit dhe transparencës së tij, veçanërisht nga qeveria, dhe së dyti lidhur me përmbajtjen e këtij ligji, siç përshkruhet në Raportin e MM 2020.

Si rezultat i mobilizimit të gjerë të sektorit jofitimprurës të drejtuar nga Partnerët Shqipëri dhe analizave ligjore e propozimeve të paraqitura, 32 nene të projektligjit fillestar u ndryshuan, me ndryshimin kryesor në ushtrimin e të drejtës së organizimit pa detyrim regjistrimi<sup>7</sup>. Megjithatë, ligji i miratuar paraqet një sërë sfidash për ushtrimin e aktivitetit të organizatave, si:

- Nivelin e lartë të gjërave për kundërvajtje administrative, në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe me kuadrin ligjor në fuqi.
- Mungesa e një procedure për çregjistrimin e OJF-ve në gjykatë dhe autoritetin përgjegjës për procesin, në rastet kur OJF-të nuk janë të regjistruara pranë organeve tatimore.

Procesi i hartimit dhe konsultimit të ligjit vuante nga një pjesëmarrje e ulët jo vetëm nga pala e OJF-ve, por edhe nga institucionet publike. Institucioni përgjegjës për zbatimin e këtij ligji, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), u fut në projektligj në momentin e fundit. Si rrjedhojë, KLGJ-ja nuk arriti të merrte një vendim për datën se kur do të bëhet efektiv regjistri elektronik siç e kërkon ligji. Arsyeja kryesore ishte mungesa e një buxheti të dedikuar për të, gjë që ngrihej gjithmonë si problem nga OJF-të në proces. Me miratimin e ligjit të ri për regjistrimin e OJF-ve, është shumë e rëndësishme që një ligj i ri për OJF-të të zëvendësojë Ligjin 8788/2001, të ndryshuar, për të reflektuar ndryshimet në sektorin e OJF-ve dhe kuadrin ligjor ndër viteve.

### 1.1.2. Ndërhyrja e Shtetit

Kuadri ligjor mbi ndërhyrjen e shtetit nuk ka ndryshuar dhe pasqyron të njëjtën situatë si në Raportin e MM 2020<sup>8</sup>. Sipas Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, 25 OJF kanë paraqitur kërkesa për çregjistrim ose likuidim gjatë vitit 2021. Për sa i përket sanksioneve, gjatë vitit 2021 sipas DPT janë dhënë 14 sanksione ndaj OJF-ve për shkelje të ligjit, pa specifikuar arsyen e tyre. Gjithashtu, sipas përgjigjes së marrë nga Qendra Kombëtare e Biznesit, janë **2,018 OJF** që kanë regjistruar pronarët e tyre përfitues, që është shumë afër numrit të OJF-ve me status tatimor aktiv.

Në vitin 2021 filloi puna për përgatitjen e Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të OJF-ve për financimin e terrorizmit, pas një sërë iniciativash ligjore që ndikuan në

<sup>7</sup> Informacioni është marrë nga faqja e internetit e Partnerëve Shqipëri [Online]

<https://partnersalbania.org/News/informacion-lidhur-me-hyrjen-ne-fuqi-te-ligjit-nr-80-2021-per-regjistrimin-e-organizatave-jofitimprurese/>

<sup>8</sup> Partners Albania, 2021 "Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2020" [Online]

<https://partnersalbania.org/publication/monitoring-matrix-on-enabling-environment-for-NPOs-developmentcountry-report-for-albania-2020/>

veprimtarinë e OJF-ve, duke përfshirë këtu ligjin për pronarët përfitues, regjistrin qendror të llogarive bankare dhe ligjin e ri të regjistrimit të OJF-ve. Nisma është pjesë e reagimit ndërkombëtar të OJF-ve për të mbrojtur hapësirën qytetare dhe për të shmangur mbirregullimin e OJF-ve në emër të PPP/LFT, në përputhje me Rekomandimin 8 të FATF-së për OJF-të. Ajo po zbatohet nëpërmjet një procesi bashkëpunues me pjesëmarrjen e OJF-ve dhe autoriteteve shtetërore, bazuar në një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ).

### 1.1.3. Sigurimi i Burimeve Financiare

Kuadri ligjor që rregullon veprimtarinë e OJF-ve për të kërkuar dhe siguruar fonde nga burime të ndryshme vendase dhe të huaja nuk ka ndryshuar në vitin 2021. Në praktikë, nuk ka kufizime apo kërkesa financiare për OJF-të, për të siguruar fonde nga burime të ndryshme legjitime.

## ***Nën-fusha 1.2. Liritë e tjera***

### 1.2.1 Liria e Tubimeve Paqësore

Një zhvillim pozitiv në drejtim të garantimit të lirisë së tubimit paqësor ishte ndryshimi i Kodit Penal, neni 262: “Organizimi dhe pjesëmarrja në tubime të paligjshme”, në përgjigje të vendimit të Gjykatës Kushtetuese Shqiptare të datës 5 maj 20219. Gjykata vendosi në favor të ndryshimit të nenit 262, i cili i konsideronte të paligjshme tubimet pa lejen e policisë.

Në vitin 2021 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHS) nxori 19 akte, duke ndryshuar Urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020 “Për ndalimin e grumbullimit në mjedise të hapura dhe të mbyllura”<sup>10</sup>, si masë parandaluese në situatën pandemike të COVID-19, duke vendosur kufizim të së drejtës së tubimeve paqësore. Pavarësisht këtyre ndryshimeve, janë organizuar protesta nga qytetarët dhe aktivistët e të drejtave të njeriut. Natyra e protestave kishin të bënin me çështje të pronës private dhe publike, dhunës në familje dhe sulmeve seksuale<sup>11</sup>, femicideve<sup>12</sup>, mjedisit, etj.

Në qershor 2021, Shqipëria zhvilloi zgjedhjet parlamentare në mes të situatës pandemike. Gjatë organizimit të fushatës elektorale, subjektet politike nuk ndoqën protokollet shëndetësore në fuqi, duke rrezikuar rëndë situatën shëndetësore në

<sup>9</sup> Gazeta Zyrtare 87/2021 [Online] <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/05/04/24/ca2d2e4d-3fc2-46da-a852-29a63dbd5dc0>

<sup>10</sup> Gazeta Zyrtare 210/2020 [Online] <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/11/17/633/5c8ca1e2-0838-4488-9f0b-2ecfbc756f45>

<sup>11</sup> Ky informacion është marrë nga faqja e internetit të organizatës CIVICUS [Online] <https://monitor.civicus.org/updates/2021/07/01/protests-over-gender-based-violence-media-banned-parliamentary-sittings/>

<sup>12</sup> Ky informacion është marrë nga faqja e internetit të organizatës CIVICUS [Online] <https://monitor.civicus.org/updates/2021/05/07/media-outlet-under-pressure-reveal-its-sources-over-confidential-data-leak/>

vend<sup>13</sup>.

### 1.2.2 Liria e Shprehjes

Shqipëria renditet e 83-ta nga 180 vende në raportin e Reporterëve pa Kufij 2021<sup>14</sup>, duke përmirësuar renditjen e saj me një vend nga viti i kaluar. Në qershor 2021, qeveria miratoi disa rezoluta<sup>15</sup> për të mbrojtur lirinë e shprehjes, gazetarët dhe për të siguruar që COVID-19 të mos pengojë aksesin në informacion dhe media. Gjithashtu, qeveria shqiptare premtoi krijimin dhe miratimin e një plani kombëtar veprimi kushtuar vetëm garantimit të sigurisë së gazetarëve, duke shtuar që shoqëria civile, akademikët, gazetarët dhe shoqatat profesionale, do të jenë pjesë e këtij procesi<sup>16</sup>. Prej qershorit, nuk pati përditësime nga qeveria në lidhje me këtë.

Në të njëjtin muaj, Kryesia e Kuvendit të Shqipërisë<sup>17</sup> vendosi ndryshimin e rregullores për akreditimin e mediave dhe sistemin audio-vizual për transmetimin e mbledhjeve të komisioneve parlamentare. Në bazë të ndryshimeve, gazetarët nuk do të mund të ishin të pranishëm në mbledhjet e komisioneve parlamentare, por do të mund t'i ndiqnin ato nëpërmjet një sistemi audio-video në një sallë të caktuar për median. Pas reagimeve të Unionit të Gazetarëve Shqiptarë dhe shoqatave ndërkombëtare të gazetarëve që e konsideruan atë si kufizim të lirisë së medias, si dhe protestave të gazetarëve, Kuvendi u tërhoq nga ky vendim<sup>18</sup>. Në lidhje me paketën “anti shpifje”, dekreti i presidentit për rikthimin e këtij ligji, i miratuar në vitin 2019, ka mbetur “i ngrirë” dhe gjatë vitit 2021 i përfshirë në kalendarin e seancave e komisionit të medias.

### 1.2.3. Akses në Informacion

Kuadri ligjor ofron mundësinë e komunikimit dhe aksesit në çdo burim informacioni, përfshirë internetin dhe teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. Asnjë ndryshim ligjor nuk ka ndodhur në vitin 2021 dhe mjedisi ligjor pasqyron Raportin e MM 2020<sup>19</sup>. Depërtimi i internetit në Shqipëri ishte 69,6% ndërkohë numërohen 2 milionë përdorues të internetit në Shqipëri<sup>20</sup>.

<sup>13</sup> Ky informacion është marrë nga faqja e internetit të organizatës Friends of Europe [Online]

<https://www.friendsofeurope.org/insights/albanian-elections-during-covid-19-democracy-must-remain-a-top-priority/>

<sup>14</sup> Reporters Without Borders, 2021 [Online] [World Press Freedom Index](#)

<sup>15</sup> Informacioni është marrë nga portali exit.al [Online] [Elisa Spiropali Promises Council of Europe to Protect Journalists, Support Independent Media - Exit - Explaining Albania](#)

<sup>16</sup> <https://monitor.civicus.org/updates/2021/07/01/protests-over-gender-based-violence-media-banned-parliamentary-sittings/>

<sup>17</sup> <https://www.parlament.al/Files/Lajme/Dokument/RREGULLORE%20PER%20AKREDITIMIN%20E%20MASMEDIES.pdf>

<sup>18</sup> [www.parlament.al/Files/Lajme/Dokument/RREGULLORE%20PER%20AKREDITIMIN%20E%20MASMEDIES.pdf](https://www.parlament.al/Files/Lajme/Dokument/RREGULLORE%20PER%20AKREDITIMIN%20E%20MASMEDIES.pdf)

<sup>19</sup> Partnerët Shqipëri, 2021 “Matrica e Monitorimit për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Raporti për Shqipërinë 2021”, pg.27 [Online] <https://partnersalbania>.

<sup>20</sup> Informacioni është marrë nga portali i të dhënave DataReportal [Online] [Digital in Albania: All the Statistics You Need in 2021 — DataReportal – Global Digital Insights](#)

## ***Fusha 2: Kuadri për qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat financiare për OJF-të***

### ***Nën-fusha 2.1. Trajtimi tatimor/fiskal për OJF-të dhe donatorët e tyre***

#### **2.1.1. Përfitimet Tatimore**

Në dhjetor 2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nxorri një udhëzim mbi procedurën e rimbursimit të TVSH-së për fondet e donatorëve të huaj për OJF-të. Me këtë rregullore në fuqi<sup>21</sup>, të gjitha marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë ose marrëveshjet e granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave kualifikohen për rimbursimin e TVSH-së. Gjithashtu, subjekt i rimbursimit të TVSH-së janë skemat e nën-granteve të zbatuara nëpërmjet organizatave ndërmjetëse. Në vitin 2021 vërehet progres në zbatimin e këtij udhëzimi. Sipas informacionit të marrë nga DPT, janë 34 OJF që kanë regjistruar projektet e tyre për rimbursim të TVSH-së, dhe 4 prej tyre janë rimbursuar tashmë në vitin 2021. Kjo është hera e parë që OJF-të kanë sukses në rimbursim që kur u prezantua udhëzimi i parë.

Pavarësisht udhëzimit të miratuar, interpretimi i organeve tatimore është i ndryshëm. Si rezultat, OJF-të duhet të dorëzojnë dokumenta shtesë në formate të ndryshme krahasuar me atë të përcaktuar në udhëzim. Këto kërkesa vijnë kryesisht nga fakti se autoritetet tatimore ende nuk janë plotësisht të vetëdijshëm për rregullat dhe procedurat që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet OJF-ve dhe donatorëve të tyre, dhe nivelit të lartë të mosbesimit. Duke pasur parasysh se zbatimi efektiv i rimbursimit të TVSH-së kërkon edhe përshtatje të procedurave nga institucionet donatore do të ishte e dobishme të përfshiheshin edhe ata si pjesë e kësaj fushate sensibilizuese.

Një sistem i ri faturimi dhe monitorimi i aktiviteteve të të gjithë tatimpaguesve të regjistruar, përfshirë OJF-të, zbatohet nga autoritetet tatimore shqiptare, duke çuar në fiskalizimin e sektorit. Sistemi lejon fleksibilitet në faturim për organizatat që plotësojnë kriteret e mëposhtme: (i) nuk i nënshtrohen TVSH-së, (ii) nuk kanë shkelje në lidhje me moslëshimin e faturës në 3 vitet e fundit, (iii) kanë jo më shumë se një ambient për të ushtruar veprimtarinë e tyre dhe (iv) të kenë të punësuar/të vetëpunësuar vetëm një person.

<sup>21</sup> Informacioni është marrë nga faqja e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve [ Online] <https://www.tatime.gov.al/shkarko.php?id=6990>

Këto dy ndryshime ligjore e proceduriale, si dhe mënyra se si janë zbatuar deri më tani kanë nxjerrë në pah nevojën për më shumë trajnim dhe ndërgjegjësim të administratës tatimore. Kjo nevojë rezulton e rëndësishme edhe për OJF-të që ishin të papërgatitura kur ndryshimet hynë në fuqi. Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile u përpoq të zbuste hendekun e ndërgjegjësimit për kërkesat e ligjit, por edhe sfidat digjitale, duke ofruar trajnime dhe asistencë në shkallë të gjerë për regjistrimin e sektorit në këto sisteme. Për sa i përket Udhërrëfyesit, asnjë nga masat e Prioritetit 9, që ka të bëjë me raportimin financiar/kontabilitetin dhe trajtimin tatimor të OJF-ve nuk është adresuar gjatë vitit 2021, siç është planifikuar në Planin e Veprimit të Udhërrëfyesit.

### 2.1.2. Stimujt për Dhurimin Individual/Korporativë

Gjatë vitit 2021 nuk pati ndryshime ligjore mbi dhurimet e individëve dhe korporatave. Në vitin 2021, janë organizuar 579 fushata për mbledhjen e fondeve dhe dhurimeve të individëve dhe korporatave me një shumë totale prej 262,465,000 lekë (rreth 2.1 milionë EUR). Këto fushata u identifikuan nga Partnerët Shqipëri përmes Monitorimit të Aktivitetit Filantropik nëpërmjet Medias dhe Platformave Online<sup>22</sup>, i vetmi instrument në vend që monitoron këto të dhëna në Shqipëri. Rreth 21% e këtyre dhurimeve janë kanalizuar përmes OJF-ve.

## ***Nën-fusha 2.2. Mbështetja e shtetit***

### 2.2.1. Disponueshmëria e Financimit Publik

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mbetet mekanizmi kryesor publik që ofron mbështetje financiare për OJF-të përmes financimit publik. Për këtë raport monitorimi janë identifikuar si më poshtë burimet e financimit nga institucionet publike për vitin 2021. Këto janë të vetmet institucione që iu përgjigjën kërkesës sonë për informacion, ku përfshiheshin 15 ministri të linjës dhe AMShC. Nuk pati përgjigje nga institucionet e tjera. Informacioni i mbledhur u vërtetua duke kontrolluar informacionin publik në faqen e tyre të internetit.

<sup>22</sup> Partnerët Shqipëri, 2022, Revista e Filantropisë [Online] [http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2022/02/philanthropy.ed\\_3.pdf](http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2022/02/philanthropy.ed_3.pdf)

Tabela 1: Financimi publik nga institucionet publike

Institucionet	Numri i thirrjeve për propozime	Aplikimi i dorëzuar në total	OJF-të fituese	VF 2021
AMSHC	1	236	72	90 million Lekë (përafërsisht 744,000 EUR)
Ministria e Kulturës <sup>23</sup>	1	152	104	54,320,000 Lekë (përafërsisht 449,000 EUR)
Fondi i Llotarisë Kombëtare	1	Asnjë informacion	Asnjë informacion	Asnjë informacion
AAPSK <sup>24</sup>	1	Asnjë informacion	7	18.6 million Lekë (përafërsisht 155,000 EUR)
Agjencia Kombëtare e Rinisë	1	66	12	28,722,680 Lekë (përafërsisht 239,355 EUR)
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1	73	7	17,215,147 Lekë (përafërsisht 143,000 EUR)
Ministria e Drejtësisë	1	10	Asnjë	8,000,000 Lekë (përafërsisht 66,600 EUR)

Ministria e Drejtësisë, publikoi një thirrje për projekt propozime për të mbështetur OJF-të që janë të licencuara nga ministria për të ofruar ndihmë ligjore falas. Pas vlerësimit të 10 (dhjetë) aplikimeve të marra, Komisioni Vlerësues dhe Komisioni i Ankesave nuk shpallën fitues asnjë organizatë.

Një nga masat e Prioritetit 8: Krijimi i një kuadri financimi publik në mbështetje të programeve të OJF-ve në përputhje me praktikën më të mira të BE-së është: Rishikimi i legjislacionit ekzistues për financimin e nismave të OJF-ve nga institucionet e qeverisjes vendore dhe qendrore bazuar në analizën e mangësive, duke përfshirë specifikimin e procedurave për thirrjen për propozime. Për vitin 2021 nuk është kryer dhe raportuar asnjë analizë dhe si rrjedhojë nuk është bërë asnjë ndryshim në legjislacionin në fuqi.

## 2.2.2. Shpërndarja e Financimit Publik

Jo të gjitha institucionet publike që ofrojnë mbështetje financiare kanë rregulla dhe procedura publike për afatet kohore, përzgjedhjen dhe kriteret e dhënies së financimit. AMSHC-ja përbën përjashtim në këtë drejtim. Çdo gjë që lidhet me procedurat e grantit është publike dhe e disponueshme në faqen e tyre të internetit.

<sup>23</sup> Informacioni është marrë nga faqja e internetit të Ministrisë së Kulturës [Online]

[https://www.kultura.gov.al/wp-content/uploads/2021/01/NJOFTIMI\\_LISTA.pdf](https://www.kultura.gov.al/wp-content/uploads/2021/01/NJOFTIMI_LISTA.pdf)

<sup>24</sup> Informacioni është marrë nga faqja e internetit të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara [Online] <https://aapsk.gov.al/ceremonia-e-firmosjes-se-kontratave-me-ojf-te-e-shpallura-fituese-te-projekteve-qe-financohen-nga-para-te-konfiskuara-nga-krimi-me-vendim-te-komitetit-nderinstitucional-per-masat-kunder-krimit-te-or/>

Shpallja e procedurës është publike dhe ofron kohë të mjaftueshme për përgatitjen (më shumë se 30 ditë) dhe dorëzimin e projekt propozimeve dhe të gjitha dokumenteve të kërkuara. Për thirrjen e 2021 AMSHC-ja organizoi konsultime me OJF-të për të përcaktuar fushat e saj prioritare.

### 2.2.3. Llogaridhënia, Monitorimi dhe Vlerësimi i Financimit Publik

Nga monitorimi i të gjitha faqeve zyrtare të internetit të institucioneve publike që kanë ofruar mbështetje financiare për OJF-të gjatë vitit 2021, përfshirë AMSHC-në, rezultoi se nuk ka raporte vlerësimi rreth impaktit të financimit publik të shpërndarë për OJF-të. Mungesa e dokumenteve të disponueshme publike në lidhje me aksesin në financimin publik, procedurat e kontraktimit dhe monitorimit të tyre e bëjnë financimin publik të veprimtarisë së OJF-ve jo transparente, duke rritur shkallën e skepticitizmit ndaj shpërndarjes së fondeve publike.

### 2.2.4. Mbështetje jofinanciare

Të vetmet institucione që kanë ofruar mbështetje jofinanciare për OJF-të, nga ato institucione që kthyhen përgjigje, janë AMSHC-ja dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë. Lloji i mbështetjes së ofruar ka qenë lehtësimi i dialogut me aktorë të ndryshëm dhe përdorimi i mjediseve fizike pa pagesë. Në vitin 2021, Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara vuri në dispozicion një pronë të konfiskuar për ripërdorim social për OJF-të.

## ***Nën-fusha 2.3. Burimet njerëzore***

### 2.3.1. Punësimi në OJF

Kuadri ligjor nuk pati ndryshime lidhur me punësimin në OJF. Sipas informacionit të marrë nga DPT-ja, në sektorin e OJF-ve janë të punësuar **9,872 punonjës** në vitin 2021 me rritje të ulët krahasuar me një vit më parë prej vetëm 79 punonjësish (9,793 punonjës). Numri i punonjësve tregon një stanjacion edhe pse janë 230 OJF të reja të regjistruara pranë organeve tatimore në vitin 2021.

Asnjë informacion nuk u dha nga DPT-ja në lidhje me numrin e punonjësve me kohë të plotë kundrejt numrin e punonjësve me kohë të pjesshëm, megjithëse ky informacion mblidhet mbi baza mujore përmes deklaratave të dorëzuara nga OJF-të.

### 2.3.2. Vullnetarizmi në OJF

Edhe pse masa 5.2 e Udhërrëfyesit parashikonte ndryshimin e ligjit për vullnetarizmin dhe akteve të tjera brenda vitit 2021, nuk ka pasur zhvillime ligjore. Siç dëshmohet



dhe raportohet rregullisht nga OJF-të që punojnë me vullnetarë, ligji paraqet një sërë pasigurish dhe mungesë qartësie që kanë ndikuar negativisht në angazhimin e vullnetarëve. Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri së bashku me një grup organizatash vijoi të advokonte për ndryshimet në ligj, duke kërkuar ndër të tjera sqarimin e natyrës së marrëdhënieve kontraktuale ndërmjet vullnetarit dhe subjektit pritës dhe detyrimet tatimore të palëve përkatëse.

### 2.3.3. Arsimi Joformal

Nuk ka ndryshime ligjore në lidhje me arsimin joformal. Angazhimi qytetar/vullnetarizmi trajtohet si temë e veçantë, pjesë e lëndës së edukimit qytetar në shkollën fillore. OJF-të janë të përfshira në ofrimin e arsimit joformal brenda dhe jashtë sistemit arsimor. Në tetor 2021, qeveria miratoi Strategjinë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe planin e saj të veprimit, i cili përfshin arsimin joformal. OJF-të konsiderohen si partnerë në zbatimin e strategjisë<sup>25</sup>.

<sup>25</sup> VENDIM Nr. 621, datë 22.10.2021 PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR ARSIMIN 2021–2026 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E SAJ [Online] <https://arsimi.gov.al/vendim-nr-621-date-22-10-2021-per-miratimin-e-strategjise-kombetare-per-arsimin-2021-2026-dhe-te-planit-te-veprimit-per-zbatimin-e-saj/>

## **Fusha 3: Marrëdhëniet Shtet-OJF**

### **Nën-fusha 3.1. Korniza dhe praktikat për bashkëpunim**

#### **3.1.1. Politikat dhe Strategjitë Shtetërore për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile**

Strategjia kryesore për zhvillimin dhe bashkëpunimin e shtetit me shoqërinë civile është Udhërrëfyesi për Politikën e Qeverisë drejt një Mjedisit më Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019-2023. Tre vite pas miratimit të Udhërrëfyesit të rishikuar, vërehet një progres i kufizuar mbi zbatimin e masave të tij. Pothuajse asnjë nga masat e planifikuara për t'u realizuar deri në fund të vitit 2021 nuk është zbatuar (zbatimi i pjesshëm i shumë pak masave), dhe nuk ka asnjë raport mbi monitorimin dhe vlerësimin e progresit të zbatimit të Udhërrëfyesit.

Në qershor 2021, AMSHC-ja organizoi një takim me OJF-të për të diskutuar zbatimin e Udhërrëfyesit, por nuk u prodhua as raporti vijues dhe as u ndërmor ndonjë veprim. Udhërrëfyesi u diskutua gjithashtu në një takim të anëtarëve të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC), duke mos dhënë rezultate. Për të përshpejtuar zbatimin e tij, kërkohet angazhim më i madh nga qeveria, burime në dispozicion dhe koordinim më i mirë ndërmjet palëve të interesit.

#### **3.1.2. Institucionet dhe Mekanizmat për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile**

Nuk ka patur progres rreth punës dhe ndikimit të institucioneve dhe mekanizmave për zhvillimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile. Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC), i krijuar në vitin 2016 si një organ konsultativ i pavarur kolegjial, që synon të garantojë bashkëpunimin institucional midis shtetit dhe OJF-ve, ka qenë joaktiv gjatë vitit 2021, duke mos organizuar asnjë mbledhje. Në vitin 2021, anëtarët e OJF-ve zgjedhën zëvendëskryetarin dhe diskutuan Udhërrëfyesin mes tyre.

Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian (KKIE), një strukturë e rëndësishme në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, ka organizuar 4 takime dhe 3 aktivitete ndërgjegjësuese gjatë vitit 2021<sup>26</sup>. Gjithashtu në Këshill janë zgjedhur 14 anëtarë të OJF-ve<sup>27</sup>, të gjithë organizata me qendër në Tiranë.<sup>28</sup>

<sup>26</sup> Informacioni është marrë nga faqja e internetit të Kuvendit të Shqipërisë [Online] <https://www.parlament.al/Files/Integrimi/raport2021.pdf>

<sup>27</sup> Informacioni është marrë nga faqja e internetit të Kuvendit të Shqipërisë [Online]

Një takim i posaçëm i KKIE-së u organizua në lidhje me kontributin dhe rolin e shoqërisë civile gjatë procesit të negociatave me BE-në. Në këtë takim, përfaqësues të OJF-ve në Këshill, si dhe OJF të tjera të ftuara shprehën shqetësimet e tyre ndaj institucioneve të cilat neglizhojnë kontributin e shoqërisë civile, mungesën e ndjekjes së çështjeve të ngritura në mbledhjet e këshillit, vonesat në krijimin e tryezave konsultative për kapitujt e negociatave. Ata theksuan rëndësinë e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në tryeza të rrumbullakëta.

## **Nën-fusha 3.2. Përfshirja në procesin e vendimmarrjes dhe politikave**

### **3.2.1 Standardet për Përfshirjen e OJF-ve**

Konsultimet dhe pjesëmarrja e OJF-ve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrjes mbeten të ulëta, pavarësisht nga kuadri ligjor mundësues.

Në vitin 2021, Mekanizmi i Pavarur i Raportimit (IRM) publikoi Rishikimin e Planit të Veprimit të Partneritetit të Qeverisjes së Hapur (PQH) për Planin e Pestë të Veprimit për Shqipërinë 2020 -2022<sup>29</sup>. Sipas dokumentit, Shqipëria nuk ka përmbushur kërkesat minimale për të vepruar sipas procesit të PQH-së. Dështimi kryesor mbetet mungesa e krijimit të një forumi të dedikuar shumëpalësh apo hapësirë për diskutim ndërmjet shoqërisë civile dhe qeverisë mbi procesin e planit të veprimit, duke përfshirë monitorimin e zbatimit të planit aktual si dhe zhvillimin e planit të ardhshëm të veprimit.

Pjesëmarrja e shoqërisë civile në procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian kryhet përmes Platformës së Partneritetit për Integrim Evropian. Në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.113, datë 30.08.2019<sup>30</sup>, dy janë format e pjesëmarrjes: bordi drejtues dhe 33 tryeza të diskutimit dhe të këshillimit. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka krijuar një hapësirë të dedikuar online, që synon të japë informacion mbi projektqëndrimin negociues të Republikës së Shqipërisë për kapitujt përkatës acqui; programimin dhe monitorimin e ndihmës së Bashkimit Evropian, hartimin e Planit për Integrimin Evropian ose të planeve të tjera në kuadër të procesit të integritimit evropian, si dhe çështje të tjera që duhet të këshillohen me strukturat joshtetërore të përfaqësimit publik në kuadër të procesit të integritimit. Përtej informacionit mbi strukturat dhe procesin e negociatave, si dhe cilat janë 33 tryeza të diskutimit dhe të këshillimit për kapitujt acqui, platforma nuk përmban informacion mbi aktivitetet që po zbatohen mbi to. Edhe pse janë krijuar disa tryeza diskutimi dhe këshillimi, ajo nuk ofron asnjë informacion mbi anëtarët e tyre, apo informacion rreth minutave të

---

<https://www.parlament.al/Files/Integrimi/ListaOSHCKKIE.pdf>

<sup>28</sup> Informacioni është marrë nga faqja e internetit të Kuvendit të Shqipërisë [Online] [\\*MbledhjeKKIE15dhjetor21.pdf \(parlament.al\)](https://www.parlament.al)

<sup>29</sup> Informacioni është marrë nga faqja e internetit të Partneritetit të Qeverisjes së Hapur [Online] [https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2021/07/Albania\\_Action-Plan-Review\\_2020-2022\\_ALB\\_for-public-comment.pdf](https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2021/07/Albania_Action-Plan-Review_2020-2022_ALB_for-public-comment.pdf)

<sup>30</sup> <http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2020/04/3.-Urdher-i-KM-no.113-dt.30.08.2019-PPIE.pdf>

takimeve. Pavarësisht skepticizmit të shprehur nga aktorët e shoqërisë civile mbi qartësinë e kriterëve të aplikimit dhe vendimmarrjes për pjesëmarrjen në këto tryeza, nuk është konstatuar asnjë përmirësim. Nga faqet e internetit dhe informacionet e disa ministrive, janë ngritur disa tryeza diskutimi dhe këshillimi në 2021, si tryeza për kapitullin 23 nën drejtimin e Ministrisë së Drejtësisë, tryezat për 10 kapitujt nën drejtimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, etj. Niveli i ulët i angazhimit të shoqërisë civile në këtë proces vjen jo vetëm si rezultat i proceseve joefektive të konsultimit që janë zhvilluar ndër vite, por edhe i informacionit të limituar në platformë, procesin e negociatave në vetvete dhe rolin e pritur të shoqërisë civile në këto tryeza të diskutimit dhe këshillimit.

Në nëntor 2021, Kuvendi miratoi Ligjin 107/2021 "Për Bashkëqeverisjen"<sup>31</sup>. Ligji synon të zgjerojë pjesëmarrjen e publikut në politikëbërje dhe vendimmarrje dhe të rrisë përgjegjshmërinë e administratës publike, nëpërmjet krijimit të një agjencie dhe një platforme online ku qytetarët dhe palët e ndryshme të interesit mund të marrin informacion, të bëjnë komente dhe të paraqesin ankesa. Agjencia do t'i raportojë Kryeministrit dhe do të ketë koordinatorët e saj në institucionet e tjera të ngarkuara me monitorimin, ndjekjen dhe trajtimin e problematikave të regjistruara në platformën online. Ligji nuk u publikua në regjistrin elektronik të konsultimit publik, dhe kjo ishte një nga arsyet që ligji u kthye për rishikim nga Presidenti<sup>32</sup>, por u miratua me votat e shumicës.

Edhe këtë vit, Kuvendi i Shqipërisë duket që është institucioni më i hapur ndaj publikut dhe shoqërisë civile. Ata vazhdojnë të kenë regjistrin e pyetjeve dhe përgjigjeve dhe kanë caktuar koordinatorin për shoqërinë civile. Bazuar në përgjigjen e marrë nga Kuvendi i Shqipërisë, në seancat publike kanë marrë pjesë 73 OJF. Përsa i përket aspekteve të tjera të pjesëmarrjes dhe konsultimit ato mbeten të njëjta si vitin e kaluar.

Tabela 2: Pjesëmarrja e OJF-ve në Komisionet Parlamentare

<b>Komisionet e Përhershme</b>	<b>Seancat publike</b>	<b>Përfaqësues të OJF-ve</b>
Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut	8	23
Komisioni për Integritet Evropian	0	0
Komisioni për Punë të Jashtme	0	0
Komisioni për Ekonominë dhe Financat	2	3
Komisioni për Sigurinë Kombëtare	3	0
Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregti dhe Mjedis	6	16
Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Çështje Sociale	25	24
Komisioni për Arsimin dhe Mjetet e Informimit Publik	1	7

<sup>31</sup> Informacioni është marrë nga faqja e internetit të Qendrës së Botimeve Zyrtare [Online] <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/02/17/90/b8a74244-4688-4227-bfb6-f75c873a5708>

<sup>32</sup> Informacioni është marrë nga faqja e internetit të presidencës [Online] <https://president.al/wp-content/uploads/2021/11/Arsyet-e-Kthimit-te-Ligjit-nr.-107-2021-26.11.2021.pdf>

### 3.2.2 Qasja e Publikut në Draft Politika dhe Ligje

Urdhërat e reja të hartuara nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në vitin 2020, përkatësisht: 1) Urdhri nr. 187, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Programit të Rishikuar të Transparencës” dhe 2) Urdhri nr.188, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Regjistrimit të Rishikuar të Kërkesave dhe Përgjigjeve” hynë në fuqi në qershor 2021. Formatet e reja ofrojnë përmirësime për sa i përket datës së regjistrimit të kërkesës, datës së përgjigjes dhe llojeve të përgjigjes së dhënë (përgjigje e plotë, përgjigje e kufizuar, e refuzuar ose e deleguar), duke adresuar disa nga çështjet problematike me të cilat përballen OJF-të gjatë ushtrimit të së drejtës së tyre për informim.

Në vitin 2021, nga monitorimi i 313 autoriteteve publike, u vu re se 300 autoritete publike kanë publikuar në faqen e tyre programin e transparencës, 286 kanë publikuar kontaktin e koordinatorit për të drejtën e informimit dhe 217 kanë publikuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve<sup>33</sup>. Problematik mbetet zbatimi i së drejtës për informim, siç dëshmohet edhe nga përgjigjet e ministrive të marra në kuadër të këtij raporti. Kërkesës për informacion iu përgjigjën vetëm katër ministri nga 15 ministri, informacioni i dhënë ishte i pjesshëm dhe në një rast (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) kërkesa iu delegua AMSHC-së, edhe pse informacioni i kërkuar lidhej me veprimtarinë e ministrisë, dhe jo agjencisë.

Në vitin 2021, Komisioneri përgatiti një draft ligj për përmirësimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke synuar forcimin e rolit të koordinatorëve për të drejtën e informimit. Ai do të nënshtrohet procesin të konsultimit në vitin 2022.

### 3.2.3 Përfaqësimi i OJF-ve në organet ndërsektoriale

Përfaqësimi i OJF-ve në organet vendimmarrëse ndërsektoriale mbetet elementi më i dobët i përfshirjes së OJF-ve në politikë dhe vendimmarrje në Shqipëri. Nuk ka dëshmi të pjesëmarrjes së OJF-ve në këtë strukturë. Këtë e vërtetojnë edhe përgjigjet e marra nga ministritë (katër që iu përgjigjën kërkesës për informacion për këtë raport).

<sup>33</sup> Informacioni është marrë nga faqja e internetit të Kuvendit të Shqipërisë [Online] [20220412133422RAPORTI\\_VJETOR\\_2021\\_FINAL\\_PDF.pdf](https://www.parlament.al/20220412133422RAPORTI_VJETOR_2021_FINAL_PDF.pdf) (parlament.al)

## **Nën-fusha 3.3. Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve**

### **3.3.1. Angazhimi i OJF-ve në Ofrimin e Shërbimeve dhe Konkurrenca për Kontratat Shtetërore**

Në vitin 2021 janë miratuar një sërë VKM-sh për zbatimin e Ligjit të ri për Prokurimin Publik<sup>34</sup>, përfshirë VKM nr. 768, datë 15.12.2021 “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit dhe rregullat e detajuara për prokurimin e tyre”.

Në maj 2021 u miratuan standardet minimale për kujdesin social për personat LGBTQI në qendrat reziduale publike dhe jopublike<sup>35</sup>.

OJF-të mbeten ofruesit kryesorë të shërbimeve për një gamë të gjerë individësh, familjesh dhe grupesh në nevojë në vend. Shumica e ofruesve të shërbimeve jopublike janë organizata të shoqërisë civile. Në Shqipëri 493 shërbime sociale ofrohen nga 399 ofrues shërbimesh, nga të cilët 46% janë institucione publike, 42% janë institucione jo publike dhe 12% e shërbimeve ofrohen nga institucione të përbashkëta (publike dhe jopublike)<sup>36</sup>.

### **3.3.3. Procedurat për Kontraktimin e Shërbimeve**

VKM nr. 768, datë 15.12.2021 ka përcaktuar një procedurë të thjeshtuar për shërbimet sociale dhe shërbimet e tjera specifike, për të cilat është përcaktuar pjesëmarrja e OJF-ve në procedurat e prokurimit, në përputhje me direktivat e BE-së.

### **3.3.4. Llogaridhënia, Monitorimi dhe Vlerësimi i Ofrimit të Shërbimeve**

Përgjegjësia, monitorimi dhe vlerësimi i ofrimit të shërbimit është në përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, në përputhje me VKM nr.285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, ndryshim me VKM nr.710, datë 24.11.2021.

<sup>34</sup> Informacioni është marrë nga faqja e internetit e Agjensisë së Prokurimit Publik

<https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=8031e2e4-710a-4f61-9b15-378aef3f38f9>

<sup>35</sup> UNDP, 2021, “Hartëzimi i Shërbimeve Sociale në Shqipëri” [Online]

[https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/\\_mapping-of-social-services-in-albania.html](https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/_mapping-of-social-services-in-albania.html)

<sup>36</sup> Ibid, fq. 5